

NJOFTIM
Nr. 324, datë 19.7.2021

**PËR SHPALLJEN E KONKURRIMIT PËR NJË VEND TË LIRË PUNE PRANË
GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE**

Në zbatim të ligjit nr. 98/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe të Kodit të Punës”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje shpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin:

(emërim i përkohshëm deri në rifillimin e punës nga ana e punonjësës aktuale, për arsye të lejes së barrë lindjes), në pozicionin:

Punonjës IT dhe marrëdhënie me publikun

Kategoria e pagës: IV-a

Neni 46, i ligjit nr. 98/2016, datë 6.10.2016

Marrëdhëniet me publikun

1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që:

a) t’i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara;

b) t’i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik;

c) të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik;

ç) të sigurohet informacion në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore;

d) të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.

2. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

3. Shërbimi i marrëdhënieve me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme.

4. Këshilli i Gjykatës cakton nëpunësin civil gjyqësor për marrëdhëniet me publikun si koordinator, në përputhje me ligjin për kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

5. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun.

Neni 47

Shërbimi i teknologjisë së informacionit

Shërbimet e teknologjisë së informacionit sigurojnë:

a) mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykatë, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

b) ruajtjen e rregullt të statistikave të gjykatës.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati, janë:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë (diplomë në teknologji informacioni, shkenca kompjuterike, inxhinieri kompjuterike) të paktën në nivel master shkencor ose profesional ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë.

2. Të ketë kryer të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

3. Të ketë aftësi të mira komunikuese.

4. Eksperienca në punë përbën avantazh.

5. Nota mesatare përbën avantazh.

Dokumenti i nevojshëm që duhet të paraqesë kandidati:

Kandidati duhet të paraqesë pranë institucionit këto dokumente:

1. Kërkesa e kandidatit drejtuar institucionit.

2. Jetëshkrimi i kandidatit (CV).

3. Diploma universitare me listën e notave (kopje e noterizuar).

4. Fotokopje e kartës së identitetit, certifikatë personale me fotografi.

5. Libreza e punës.

6. Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata se nuk është në procedim hetimor dhe gjyqësor.

7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji).

8. Vërtetim vendbanimi.

9. Dëshmi të tjera kualifikimi, nëse ka.

10. Vërtetim të lëshuar nga KML-ja.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në origjinal ose të noterizuara.

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht për skualifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është deri në datën 6.9.2021.

KRYETARE E GJYKATËS
Esmeralda Xhili(Çeka)